



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 30.11.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Gresa Lahu (PDK), Rita Zeqiri (VV), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

Të pranishëm ishin edhe: Arta Balaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës dhe Granit Rugova, drejtor në Drejtorinë e Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Valbona Ajeti, kryesuese e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për mbledhje propozoi këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Kalendari i eventeve të kulturës dhe sportit;
3. Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit;
4. Koncerti i fund vitit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pika e dytë

Kalendari i eventeve të kulturës dhe sportit.

Faqe 1 nga 3

**Arta Balaj**, drejtore, tha se jemi munduar të krijojmë një kalendar të përbashkët me atë të nivelit qendrorë, pra të Ministrisë së Kulturës, por komunikimi ka qenë shumë i vështirë, prandaj ne si Drejtori e Kulturës, këtë kalendar e kemi përgatitur në bazë të informacioneve që i kemi marr nga jashtë dhe në bazë të thirrjeve që i kemi bërë në institucione të ndryshme, por jo përmes Ministrisë së Kulturës.

Në këtë kalendar janë të planifikuara aktivitetet për muajin nëntor dhe dhjetor, nga Drejtoria e Kulturës dhe Sportit, por edhe të njëjste bartëse si Biblioteka, Teatri Dodona, Qendra Kulturore për Rini dhe Fëmijë dhe disa institucione kulturore të cilat ne i përkrahim. Unë do të e rishikoj edhe njëherë këtë kalendar dhe më pas do ta përcjell tek ju.

**Granit Rugova**, drejtor, tha se në këtë kalendarë janë të përfshira pesë aktivitete: "Kampionati shtetërorë në karate", që mbahet me 3 dhjetor, "Të fluturojmë me "Hizdri Gubetin", e cila do të mbahet me 5 dhjetor, "Superkupa e Kosovës në basketboll", 07-11 dhjetor, Prishtinë, "Turneu Top 8", e organizuar nga "Klubi i Pingpongut "Priping", ku do të marrin pjesë 8 ekipet me të mira të vendit, dhe "Prishtina Tournament Futsal".

**Rita Zeqiri**, tha se kalendari i eventeve kulturore dhe sportive ka rëndësi mjaft të madhe sidomos në aspektin e promovimeve të këtyre eventeve, e cila pastaj do të ndikoj me pjesëmarrjen sa me të madhe. Ajo tha se në këtë kalendar duhet të përfshihen disa nga eventet e rëndësishme të qytetit si p.sh, "Maratona e Prishtinës "dhe "3x3 Prishtina" etj.

**Arta Balaj**, drejtore, tha se këtë vit janë ndarë 50,000.00 euro, për teatrot në formën e subvencionit por ata kanë shumë me shumë nevojë për mbështetje, pasi janë duke bërë një punë mjaft të madhe.

**Endrit Zabërgja**, tha se i falënderon për kalendarin dhe besoj se viteve të ardhshme do të kemi një kalendar me shumë informacione të inkorporuara rreth eventeve si kulturore ashtu edhe sportive.

### **Pika e tretë**

#### **Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit**

**Arta Balaj**, drejtore, tha se sa i përket dekorimit të qytetit, deri vonë kemi mbetur në bisedime me Ministrinë e Ekonomisë, për shkak të kursimit të energjisë elektrike. Ne këtë vit i kemi pas 70 mijë euro të alokuara për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit, tashmë kemi marr pëlqimin edhe nga niveli qendror dhe kemi filluar punën.

Këtë vit kemi vendosur që koncentrimi i dekorimit të qytetit të behët të pjesa e rrugës "Xhorxh Bush", për shkak të mos pengimit të bizneseve në shesh, të cilat gjatë viteve të kaluara kanë pasur mjaft ankesa. Dekorimet e qytetit me ndriçime do të fillojnë nga sheshi "Skënderbeu", "Nënë Terezë" dhe "Zahir Pajaziti", ku do të vendosen dy bredha të mëdhenj si janë vendosur gjithmonë.

Të sheshi "Xhorxh Bush", është plani të vendosim një bredh natyral i përmasave 8 deri në 10 metra dhe do të rregullohet në mënyra shumë specifike. Tash shumë shpejt do të hapet afati

për aplikimin e dhënies në shfrytëzim të shtëpizave, sipas afateve dhe kritereve do të vijë deri të ndarja e tyre pastaj do ta bëjmë edhe zbulimin e këtyre shtëpizave. Podiumi ku do të përformojnë artistet do të jetë në pjesën të semaforët e katedrales, aty do të kemi muzikë me d. gj, nga data 15 dhjetor, kur edhe do të behët hapja zyrtare.

Ndërsa aktiviteti kulturor me grupe dhe me këngëtar të ndryshëm fillon nga data 24 deri me 31 dhjetor dhe çdo natë do të kemi lloje të ndryshme të muzikës.

Me datën 29 dhjetor, do ta kemi këngëtares e njohur Rona Nishliu, e cila do të perfomojë në kryeqytet dhe është një lajm mjaft i mirë për neve. Po ashtu me datën 25 do ta kemi edhe aktivitetin "Maratonën e babadimrave", e cila ka hyrë në pjesën e aktiviteteve kulturore dhe gjatë ditëve në vazhdim do ta shohim mundësinë se ka do të jetë rruga e kësaj maratone. Dritat do të jenë të ndezura nga ora 17:00 deri në ora 23:00 apo 24:00, ato ndezën nga data 15 me hapjen e shtëpizave dhe ndalen më 8 janar.

**Endrit Zabërgja**, tha se e mira e bizneseve do të ishte ndalimi i shitjes së alkoolit nën moshën 18 vjeçare.

### **Pika e pestë Të ndryshme**

**Endrit Zabërgja**, tha se sikur pjesa "Verë - Dimër", ndoshta do ishte mirë të krijohet edhe një pjesë tjetër më familjare. Propozimi i pjesës se patinazhit, dëshiroj të di nëse ekziston mundësia që në atë pjesë të shkallet e Pallatit të Rinisë, t'i vendosim edhe 3 apo 4 shtëpiza dhe të e krijojmë një hapësirë të bukur në atë pjesë. Ai po ashtu tha se e kemi një kërkesë nga "Federata e Shahut të Kosovës", për ndarjen e një hapësire për "Shtëpinë e Shahut", mjetet veç janë të siguruar përmes subvencionimit nga Ministria e Kulturës dhe si propozim është objekti i Komunës aty ku ka qenë Stacioni Policor në Lakërishtë. Besoj se aty është një hapësirë e përshtatshme, pasi kemi edhe qarkullim të mirë të trafikut urban.

**Granit Rugova**, drejtor, tha se kjo është një ide mjaft e mirë, përfaqësuesit nga Federata e Shahut të Prishtinës së pari le ta dërgojnë kërkesën në mënyra fizike, duke u drejtuar organeve të Drejtorisë së Sportit në Komunën e Prishtinës, dhe pastaj në bazë të asaj kërkesë së bashku me drejtoreshën Drejtorisë së Pronës do t'i shohim se cilat janë mundësit për të vazhduar me trajtimin e kësaj kërkesë.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:10.*

**Procesmbajtësi  
Arton Brahim**

**Kryesuesja e komitetit  
Valbona Ajeti**



Faqe3nga3